

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri (JR) 21/2018
Nr. 21/2 regj.

Tiranë, më 10.01.2019

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e Hënë, në datën 04.02.2019, ora 10:00, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentash çështja nr. (JR) 21/2018, datë 18.10.2018, për ankimin që subjekti i rivlerësimit ka bërë kundër vendimit nr. 41, datë 18.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtarët:

| | |
|----------------------------------|------------------------|
| Kryesues i Trupit Gjykses | Rezarta Schuetz |
| Relator i Çështjes | Ardian Hajdari |
| Gjyqtar | Albana Shtylla |
| Gjyqtar | Ina Rama |
| Gjyqtar | Natasha Mulaj |

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

RELATORI I ÇËSHTJES
GJYQTAR
Ardian Hajdari



KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES
GJYQTAR
Rezarta Schuetz

